



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:066278
Datë: 18.02.2020
Numri i dokumentit: 00838268
P.nr.1022/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit R.S, nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numra PP.II.nr.1761/2018, PP.II.nr.825/2019 dhe PP.II.nr.2024/2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2020, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 14.02.2020, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri R.S, nga babai O.. dhe nëna H..., e lindur S..., i lindur me datë ..., në fshatin, Komuna e Gjilanit, me vendbanim në Gjilan, lagja "...", nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i shtatë fëmijëve, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data 11.06.2018 deri me datë 01.03.2019, në kohë të papërcaktuar, në shtëpinë e tij në Gjilan, i pandehuri si konsumator i energjisë elektrike, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa autorizim ka shfrytëzuar energjinë elektrike, ashtu që fillimisht njehsori elektrik i është shkyçur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-it, ku i pandehuri, pa leje dhe autorizim ka bërë lidhjen e drejtpërdrejte në rrjetin elektrik, pa orë matëse, në atë mënyrë që ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike në shtëpinë e tij me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve elektrike dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-it, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm të përgjithshëm material në shumën prej rreth 206,09 €

-Me çka në vazhdimësi ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit R.S, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datat 08.11.2018, 18.06.2019, dhe 11.12.2019, ka ngritur aktakuzat me numër PP.II.nr.1761/2018, PP.II.nr.825/2019 dhe PP.II.nr.2024/2019, kundër të pandehurit R.S për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës dhe veprave penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

Me datë 12.02.2020, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri R.S. Në këtë seancë gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare si dhe duke pasur parasysh se ndaj të pandehurit R.S në këtë gjykatë njëkohësisht janë duke u zhvilluar 3 (tri) procedura penale në të njëjtën kohë, për vepra penale të njëjta, pas dëgjimit të palëve dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale në kuptim të nenit 35 të KPP-ës, mori aktvendim procedural me të cilin bashkoi procedurat penale ndaj të pandehurit R.S dhe atë për lëndët P.nr.1022/18, P.nr. 524/19 dhe P.nr.1127/2019/2018, me ç'rast pas bashkimit të procedurës penale dhe para leximit të aktit akuzues prokurorja e shtetit së pari ricilësoi veprat penale në nenin 314 paragrafi 1 i KPRK-ës numër 06/L-074 meqenëse i njëjti është më i favorshëm për të pandehurin si dhe më pas duke pasur parasysh se plotësohen kushte ligjore nga neni 77 i KPRK-ës, që këto vepra penale të konsiderohen një vepër penale në vazhdim, të njëjtat i ricilësoi në një vepër të vetme penale në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK, pas këtyre veprimeve i njëjti lexoi aktakuzën me ricilësimin e ri juridik ku i pandehuri kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht në procesverbalin e KEDS-it me numër ... i datës 11.06.2018, procesverbalin me numër .. i datës 03.01.2018, procesverbalin me numër ... i datës 01.09.2019, transaksionet e konsumatorit, ID e rastit ... i datës 12.06.2018 i lëshuar nga Departamenti për Konsumator-Sektorin për Rikthimin e Humbjeve, Fatura e datës 12.06.2018, , Fatura ... e datës 04.01.2019, Fatura e datës 05.03.2019, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuzat lëndore nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri R.S, ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

3.Vendimi lidhur me ricilësimin juridik të veprës penale dhe zbatimin e ligjit më të favorshëm.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare, bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP-ës, Kodin Penal të Republikës së Kosovës me numër 06/L-074, të miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës ndërsa i hyrë në fuqi me datë 14.04.2019 si dhe në nenin 3 paragrafi 2 të KPRK-ës, në të cilin thuhet se *“Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”*, po ashtu faktin se zbatimi i veprimit retroaktiv të ligjit është obligim i gjykatës dhe se me rastin e ndryshimit të ligjit duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin”, erdhi në përfundim në këtë çështje penale përkatësisht lidhur me veprën penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës, e cila i vihet në barrë të akuzuarit R.S sipas aktakuzës me numër PP.II.nr.1761/18 duhet zbatuar dispozitivin e kodit të ri penal të cilat janë më të favorshme për të akuzuarin ngase i njëjti kod këto veprime i parasheh në nenin 314 paragrafi 1 sipas të cilit *“Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”*, ndërsa në paragrafin 4 të po të njëjtit nen thuhet se për qëllime të këtij neni, *“shërbime”* përfshinë, por nuk kufizohet në transportimin; punën, shërbimet profesionale, teknike apo mekanike; shërbimet e skiliftit; objektet për biseda telefonikë; gazin, ujin, rrymën apo ngrohjen; shërbimet e komunikimit ose

telefonisë; ofrimi i ushqimit apo akomodimit; furnizimi me pajisje, vegla, vetura ose kamp-shtëpiza për përdorim të përkohshëm; furnizimi i pajisjeve për shfrytëzim; ose qasja në sistemin e internetit, kompjuterik apo kabllor sipas nenit 321 të KPRK-ës i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale thuhet se “Kushdo që lidhet apo rilidhet në përçues të rrymës apo në rrjetin për përçim ose shpërndarje të çfarëdo shërbimi komunal në çfarëdo mënyre, drejtpërdrejt apo tërthorazi, qoftë përmes përçueshmërisë ose induksionit, pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.”, çka nënkupton se gjykata duke krahasuar dispozitat e lartcekura gjeti se sipas nenit 321 të KPRK-ës, e cila ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dënimi i paraparë për këtë veprë penale ka qenë kumulativ dhe atë dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite ndërsa sipas nenit 314 të KPRK-ës, i cili tani është në fuqi dënimi për këtë veprë penale është alternativ dhe atë dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 vite dhe si rrjedhojë kualifikimi juridik sipas KPRK-ës me numër 06/L-074 është më i favorshëm për të pandehurin dhe si i tillë duhet të zbatohet.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit ti shqiptohet dënim me burgim në shumë prej 120 (njëqindnjëzet) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 viti nuk kryen veprë tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 39 të KPRK-ës, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij dhe ka kërkuar falje për veprimet e tij duke shtuar se këto veprime i ka bërë meqenëse i njëjti është i papunë, është mbajtës i familjes 9 anëtarëshe dhe se është i gjendjes së varfër ekonomike, po ashtu i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa rrethana rënduese si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës gjykata nuk gjeti ndonjë andaj duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë gjykata konsideron se ky dënim është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit po ashtu gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën KEDS, e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1022/2018, me datë 14.02.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.